

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Venhar Salihu, me praktikanten e kësaj gjykate Vjosë Berisha, në çështjen kontestuese të paditësit Xh. O. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson Elmi Qerimi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurit H. O. nga Gjilani, Rr. "15 Qershori", nr.28, të cilin përfaqëson Masar Morina, avokat nga Gjilani, me objekt kontesti pengim posedimi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datën 03.08.2016, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. O. nga Gjilani, me të cilin ka kërkuar që të vërtetohet se i paditurit H. O. nga Gjilani me datë 08.06.2015 ka penguar paditësin në posedimin e fundit faktik të paluajshmërisë së tij në ngastrën numër 02341-11, Zonë Kadastrale në Gjilan, me sipërfaqe prej 612 m<sup>2</sup>, duke i larguar puntorët e paditësit, kur të njëjtit kanë dashur të bëjnë pregaditjen e ngastrës së lartëcekur me qëllim të fillimit të ndërtimit të shtëpisë, mbrenda kufijve kadastral të ngastrës së paditësit.**

**II. DETYROHET** paditësi Xh. O. nga Gjilani që të paditurit H. O. nga Gjilani ti paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,028.10 € (njëmijë e njëzet e tetë euro e dhjetë cent).

## **A r s y e t i m i**

Paditësi Xh. O. nga Gjilani më datë 10.06.2015 në këtë gjykatë ka dorëzuar padinë dhe kërkesëpadinë ndaj të paditurit H. O., me objekt të padisë pengim posedimi me propozim të masës sigurorese.

Kjo gjykatë me aktvendimin e dt.11.6.2015 ka aprovuar propozimin për masën e përkoshme të sigurisë dhe ka obliguar të paditurin mos ti pengoj zyrtarët e Drejtorisë së Kadastrit në Gjilan për të dalur në vendine ngjarjes në ngastrën numër 02341-11 ZK Gjilan. Kundër këtij aktvendimi i padituri ka paraqitur kundërshtim dhe pas mbajtjes së senacës dëgjimore gjykata me aktvendimin e dt.19.11.2015 ka refuzuar si të pabazuar dhe masa e përkoshme është zëvendësuar me masën për sigurimin e kërkespadiës. Kundër aktvendimit të dt.19.11.2015 i padituri ka paraqitur ankesë në gjykatën e shkallës së dytë (Gjykata Apelit në Prishtinë), kurse kjo gjykatë me Aktvendimin CA.nr.4637/15 të dt.6.01.2016 e prish aktvendimin e kësaj gjykate të dt.19.11.2015 dhe lëndën e kthen në riprocedurë dhe rivendosje. Me dt.9.06.2016 gjykata ka caktuar senacë dëgjimore për masën sigurorese, por i autorizuari i paditësit e ka tërhequr propozimin për caktimin e masës sigurorese<sup>1</sup>, kurse gjykata ka caktuar sencën për çështjen kryesore për dt.4.07.2016 në fillim në ora 10.00.

I autorizuari i paditësit av.Elmi Qerimi gjatë senacës përgatitore, kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiës të paraqitur në këtë gjykatë duke theksuar se i padituri me dt.8.06.2015 nuk i ka lënë ekspertët e gjeodezisë që të njëjtit të shenojnë pikat dhe të bëjnë parcelimin e ngastrës kadastrale nr. 02341-11. Për ti vërtetuar këto fakte ka propozuar që të administrohen provat e propozuara në padi, të dëgjohen dëshmitarët M. B., R.

<sup>1</sup> Për më tepër shih proceverbalin e dt.9.06.2016 ku është kontaktuar si i tërhequr propozimi i dt.10.06.2015.

Sh.<sup>2</sup> si dhe paditësi në cilësi të palës dhe pas administrimit të provave në tërësi të aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

I autorizuari i të paditurit av.Masar Morina në përgjegje në padi, senacën përgatitore, kryesore si dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkespadinë e paditësit duke theksuar se në rastin konkret nuk ka asnjë veprim të kundërligjshëm nga ana e të paditurit, përkatësisht për të ekzistuar pengim posedimi duhet të jetë i drejtuar kundër paditësit, gjëgjësisht kundër të drejtave të tijë e në rastin konkret me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i padituri ka penguar paditësin me dt.8.06.2015. Për ta vërtetuar se i padituri nuk ka penguar në ditën kritike paditësin, përkatësisht cilat kanë qenë veprimet e të paditurit ndaj gjeodetëve ka propozuar që i padituri të dëgjohet në cilësi të palës.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Qertifikatën mbi te Drejtat e Pronës se Paluajtshëme dt.29.05.2012 për ngastrë nr.2341/11 ZK Gjilan, Konstatimin e dt. 28.06.014 e përpiluar nga M. B. dhe I. B., Skicë e matjeve në teren të dt. 08.05.014, Konstatimin e dt. 19.02.2015 punuar nga eksperti i gjeodezis Izijadin Sylja, Njoftimi nr. 10-952-51700-2015 i dt. 03.06.2015 të lëshuar nga Drejtoria e Kadstrit në Gjilan, Procesverbali për matjen në teren dt.03.06.2015 lëshuar nga R. Sh. dhe M. B., Kopja e Planit për parcela 2341/11 datës 25.05.2015, Ekstrakti për Kordinata nga data baza dhe baza grafike e planit rregulltave lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm në Gjilan, Kontrata nr.1172/88, Aktvendimi nr.951/696-06 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosoves – Komuna Gjilan, 3 Kopje të Planit të para luftës për parcelën 2341/10, Lista Poseduese e vitit 1989 në emër të H. A. O., Konarata për rregullimin e tokës nderitmiore nr. 01352-13/89 dt. 05.01.1990, Qertifikata mbi te drejtat e pronës se pa luajtshme dt.19.05.2006 për parcelën 2341/10 në emër të Osmani Hasan Ahamet, Aktgjykimi i Gjyk.Th.Gjilan C.nr 433/12 dt. 04.05.2015, dëgjimin e dëshmitarit M. B. nga Gjilani, dëgjimin e të paditurit H. O. në cilësi të palës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të nxjera në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar.**

Nga Proceverbali për matjen në teren, nr.03-06-2015 dt.8.06.2015 si dhe nga Njoftimi Nr.10-952-51700-2015 dt.9.06.2015 të lëshuar nga ana e Drejtoris së Kadastrit në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se gjeodetët R. Sh. si dhe M. B. me dt. 8.06.2015 me kërkesë të paditësit Xh. O. kanë dalur për të bërë parcelimin e ngastrës kadastrale nr.2341-11, por mexhaniku-i padituri H. O. i nuk i ka lënë që të bëjnë matjen deri sa të vendosi gjakata e shkallës së dytë në lidhje me një rast tjetër në mes palëve të njëjta.

Nga Aktgjykimi i kësaj gjykate C.nr.433/12 dt.4.05.2015 gjykata ka vërtetuar se palët ndërgjyqjese janë në procedurë me objekt konetsti vërtetimin e pronësisë.

**Nga dëgjimi i dëshmitarit M. B.** gjykata ka vërtetuar se me dt.08.06.2015 rreth orës 10 apo 11 të ditës ky dëshmitarë në cilësi të gjeodetit së bashku me kolegën e tijë R. ka dalur në teren për ta bërë matjen e parcelës me kërkesë e Xh. O.. Në momentin e arritjes tek parcela

---

<sup>2</sup> Sa i përket dëshmitarit R. Sh., i autorizuari i paditësit ka hequr dorë nga dëgjimi ë këtij dëshmitari.

simbas kërkesës këta si gjeodet kanë për obligim ta njoftojnë mexhanikun e që është H. O., pas njoftimit për arsyen se pse gjindet në këtë parcelë, ky i fundit i ka njoftuar gjeodetët se në lidhje me këtë çështje lënda gjindet në gjykatë dhe akoma nuk është përfunduar dhe për këtë arsye nuk ka dëshirë që të bëhet matja dhe ky njoftim sipas dëshmitarit ka qenë pa sharje apo fyerje por me fjalë normale. Pas këtij njoftimi dëshmitarë së bashku me kolegun e tij Sh. janë kthyer në punë pa e përfunduar matjen sipas kërkesës së paditësit Xh. O.. Ky dëshmitarë ka deklaruar se në përvojën e tij 40 vjeqare asnjëherë nuk e ka ftuar policinë për ti asistuar në këso raste e gjithashtu as në manuelin për gjedoet nuk parashihet një procedurë e tillë, por në ato raste kur megjaniku nuk lejon të kryhet matja për arye të ndryshme (dyshime tek gjeodeti, probleme në mes veti) gjeodet i mledhim mjetet dhe vazhdojnë rrugën dmth nuk e kanë patjetër ta përfundojnë matjen sipas kërkesës së palës-qytetarit. I njejt i ka deklaruar se as në rastin e parë e as në rastin e dytë (kur kanë dalë me policinë dhe përbarusin privat) i padituri H. O. nuk ka bërë problem e as nuk është fjalos me ta. Këtij dëshmitari gjykata ia fali besimin, pasi që i njejt i gjatë dhënjës së deklarates ishte i sinqerte dhe të thënat e tij ishin në përputhje me provat e tjera në shkresat e lëndës.

**Nga dëgjimi i të paditurit H. O. në cilësi të palës** gjykata ka vërtetuar se me dt.8.06.2015 diku mas orës 10 të ditës në shtëpin e tij janë paraqitur dy gjeodet me emrin M. dhe R., të njejt i ka deklaruar se kanë njoftuar të paditurin se kanë ardhur ta bëjnë matjen e shtëpisë, por i padituri i ka njoftuar se në lidhje me këtë çështje lënda gjindet në gjykatën e shkallës së dytë, kurse gjeodetët kanë kërkuar që në drejorin e kadastrit ti dorëzojnë ndonjë dokument për këtë çështje dhe pas një ore i padituri ka dorëzuar ankesën e paraqitur dhe për atë ditë me kaq ka mbaruar, kurse në ditën e nesërme në shtëpin e tij është paraqitur përbaruesi privat së bashku me katër polic dhe pas prezentimit të një dokumenti un nuk i kam penguar kurse gjeodetët kanë vazhduar me matjen. I njejt i ka deklaruar se paditësit Xh. O. ky as në ditën kritike apo ndonjë herë tjetër nuk i ka penguar dhe me të njetin nuk ka ndruar asnjë fjalë. Deklertaës të paditurit, gjykata ia falë plotësisht besimin, me arsyetimin se i njejt i ishte i sinqertë dhe deklarata e tij ishte në përputhje me provat të tjera si dhe me deklertën dëshmitarit M. B. (dëshmitarë i propozuar nga ana e paditësit).

Meqenëse në rastin konkret nuk ishte konstuese posedimi i ngastrës kadastrale nr.2341-11 ZK Gjilan, gjykata nuk e pa të arsyeshme dhe të të nevojshme të provoj faktet për këtë çështje.

Neni 7.1 i LPK-ës parasheh “ **palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet të tilla**”. I autorizuari i paditësi si provë për ti vërtetuar faktet e cekura në padi ka propozuar që të administrohen provat e propozuara në padi, dëgjimin e paditësit në cilësi të palës si dhe dëgjimin e dëshmitarit M. B., kurse i autorizuari i të paditurit ka propozuar, përkatësisht nuk i ka kundërshtuar propozimet e përfaqësuesit të paditësit por ka kërkuar që në cilësi të palës të dëgjohet edhe i padituri.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 322 të LPK-, nga admisnitrimi i provave të lartëcekura, dëgjimit të dëshmitarit M. B. si dhe dëgjimin e të paditurit H. O. erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk kemi pengim posedim, përkatësisht paditësi nuk është penguar nga ana e të paditurit në ushtrimin e pushtetit faktik në ngastrën nr.2341-11 ZK Gjilan dhe vendosi si në pikën I të këtij aktvendimi.

*Kurse sa i përket mosardhjes të paditësit për të dëgjuar në cilësi të palës (edhe përkundërfaktit se i njëjti është propozuar të dëgjohet) dhe mos ardhjen nuk e ka arsyetuar, gjykata vlerëson se i njëjti është përpjekur të pengoj daljen në pah disa fakteve dhe përpiqet të fshehë të vërtetën, por gjykata erdhi në përfundim në përputhje me të gjitha provat.*

*Gjykata vlerësoi edhe prova të tjera të administruara në shqzrtimin kryesor, por konsideron se të njetat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje kontestimore.*

*Gjykata vendosi (si në pikën II të këtij aktvendimi) që paditësi t'ia paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë: për përgjegje në padi shumë 104€, për kundërshtimin e ushtruar shumë prej 104€, për ankesën e ushtruar shumë prej 104 € (edhe për kundër faktit se i autorizuari i të paditurit kërkoi shumë prej 408 për këto dy parashtrës, por kjo shumë ne bazë të TA është për kontestet e vlerës mbi 10.000 €, kurse kontestet e pengim posedimin nuk kanë vlerë) si dhe për 3 senca shumë prej 405€ dhe për një senacë shumë prej 67.50€ (edhe përkundër faktit se i autorizuari i të paditurit ka kërkuar katër senaca, por gjykata vlerëson se senaca e dt.26.07.2016 është shtyrë nuk është mbajtur dhe për këtë arsye kjo senacë është llogaritur 67.50€), si dhe shumë prej 243.60€ e paguar për përbarusin privat, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 924.10 €, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-ës lidhur dhe Rregullorën për Tarifën e Avokatëve.*

*Nga të lartë cekurat, konform nenit 7, 322, 480 si dhe nenit 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore lidhur me nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr. 340/2015, dt.3.08.2016**

**Gjyqtari**

Venhar SALIHU

**UDHËZIM JURIDIK:** *Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, në Gjykatën e Apelit Të Kosovës në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëprëjet kësaj gjykate.*